

Drejtuar: Z. Fatmir XHAFAJ, Kryetar
Komisioni i Posacem Parlamentar “Per thellimin e reformave per mireqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin per Shqiperine 2030 ne Bashkimin Evropian”
KUVENDI I SHQIPERISE
Bulevardi “Deshmoret e Kombit”

Shoqata “Bashkimi Tregtar i Shqiperise”
Rr. Abdi Toptani, “Torre Drin”,
Zyra 22, Tirane, Shqiperi
D. 501
Nr. Prot. 467
Date: **5 Korrik 2024**

Lenda: Pergjigje Fteses se Komisionit te Posacem Nr. 2616 Prot. Date 28.06.2024 ✓

I nderuar Z. ZHAFAJ,

Se pari, deshirojme t’ju falenderojme per ftesen dhe vleresimin kundrejt Shoqates “Bashkimi Tregtar i Shqiperise”.

Gjithashtu, duke shprehur vleresimet tona per ngritjen e Komisionit te Posacem Parlamentar “Per thellimin e reformave per mireqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin per Shqiperine 2030 ne Bashkimin Evropian” i cili do te kete ne fokus skanimin dhe reformimin e luftes ndaj korrupsionit, njeherazi me kenaqesi e pranojme Ftesen tuaj dhe konfirmojme gadishmerine tone per te bashkepunuar me Komisionin e Posacem Parlamentar dhe te kontribuojme me ekspertizen dhe pervojen tone ne keto fusha te rendesishme per vendin.

Gjate aktivitetit tone si organizate perfaqesues e siper marrjes, kemi patur ne objektin tone te veprimtarise thelbesisht permiresimin e klimes se biznesit nepermjet krijimit te praktikave te drejta, konkruese, sundimin e ligjit, dhe ceshjet e mireqeverisjes ne raport me siper marrjen, nxitjen e luftes ndaj informalitetit dhe evazionit ekonomik, qe Ne besojme se jane fenomene te lidhura ngushte me korrupsionin.

Gjate aktivitetit, BTSH eshte aktive ne:

- Propozimin e ndryshimeve ligjore ne fushen ekonomike dhe jo vetem, lidhur me integrimin e praktikave te vendit tone me ato te BE dhe pershtatjen e legjislacionit tone me ate te BE;
- Pjesmarrjen ne ceshjet e Rrjetit te Koordinatorëve Kunder Korrupsionit ngritur nga Ministria e Drejtesise;
- ka ngritur nder vite se bashku me Ministrine e Financave dhe institucioneve te varesise, grupe pune *ad-hoc* me qellim skanimin e procedurave te ndryshme per te permiresuar luften ndaj informalitetit ne te gjithë zinxhirin e ketij fenomeni, si dhe Minsitrite e tjera perkateisht;
- gjithashtu pjesmarrese ne te gjitha raportet dhe ceshjet ku perfshihet komuniteti i biznesit, jo vetem nga institucionet vendase, por dhe ato te huaja, si Delegacioni Europiani ne Shqiperi, etj.

Ne kete kuader, BTSH eshte e gatshme qe te jete pjese e ketij bashkepunimi me te gjitha resurset e saj profesionale dhe te behet pjese e proceseve te Komisionit te Posaçem Parlamentar, per aktet dhe dokumentat qe do te hartohen nga ky Komision, si dhe te angazhoje ekspertet e saj per te kontribuar ne aktivitetin e ketij Komisioni e grupeve te punes prane Sekretariatit te tij.

Ne vijim te kesaj letre, do te ishte me interes per kete bashkepunim qe Ne si organizate te njiheshim me programin e punes se Komisionit, i cili ka si objekt skanimin dhe reformimin e luftes ndaj korrupsionit, ne menyre qe te konkretizojme pjeset e punes te cilat lidhen me sipermarrjen dhe per te cilat do te furnizojme me propozimet tona dhe ekspertizen e nevojshme punen e Komisionit dhe Sekretariatit te tij.

Duke ju falenderuar edhe nje here per besimin dhe ftesen tuaj, ne e mirepresim bashkepunimin me Ju dhe jemi te gatshem te japim kontributin tone maksimal per te ndihmuar ne arritjen e qellimeve per te cilat eshte krijuar Komisioni i Posaçem Parlamentar.

Per Shoqaten “Bashkimi Tregtar i Shqiperise”

Me respekt,

Mira POGAÇI
Drejtor Ekzekutiv

